



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Nr 1954/ Prot

Tiranë, më 20.04.2017

NJOFTIM

DREJTUAR: TË GJITHË OPERATORËVE EKONOMIKË TË INTERESUAR

PËR DIJENI: AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

LËNDA: *Korrigjim lapsusi në dokumentet e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje barna dhe materiale konsumi për qendrat shëndetësore që mbulojnë me shërbim zonat turistike verore” gjatë sezonit veror 2017*

Njësia e Prokurimit e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje barna dhe materiale konsumi për qendrat shëndetësore që mbulojnë me shërbim zonat turistike verore” gjatë sezonit veror 2017 total prej **20,294,606 (njëzet milion e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e gjashtë) Lekë pa TVSH**, sqaron se në DST të publikuara ne www.app.gov.al datë 18.04.2017, është bërë një lapsus dhe konkretisht:

Në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit pika 2.3. 3

ISHTE:

2.3.3 Për barnat (e listës së DST) të paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, bari që ofertohej duhet:

- të ketë marrë autorizim për tregtim dhe të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit European, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi; /ose/
- të jete i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm kur ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tyre, **si dhe në një nga vendet e Bashkimit European**

/ ose/

- të jetë i pajisur me autorizimin e tregtimit nga Agjencia Europiane e Vlerësimit të Barnave (EMA) ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Njoftojmë se shtesa në paragrafin e dytë pas presjes: **“si dhe në një nga vendet e Bashkimit European”** është shënuar gabimisht duke u kopjuar nga Ligji “Per Barnat dhe Sherbimin Farmaceutik”, në versionin e pandryshuar të tij, **NDAJ KJO FJALI HIQET DHE KRITERI 2.3.3**

BËHET:

2.3.3 Për barnat (e listës së DST) të paautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, bari që ofertohej duhet:

- të ketë marrë autorizim për tregtim dhe të qarkullojë në njërin nga vendet e Bashkimit European, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi; /ose/
- të jete i prodhuar në vendet e Ballkanit, vetëm kur ka marrë autorizim për tregtim dhe qarkullon në vendin e tyre,
/ ose/
- të jetë i pajisur me autorizimin e tregtimit nga Agjencia Europiane e Vlerësimit të Barnave (EMA) ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ky korrigjim bëhet bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Ju faleminderit për mirëkuptimin

NJËSIA E PROKURIMIT

